

## **REZOLUTA NË LIDHJE ME MBROJTJEN E DINJITETIT TË GRAVE DHE BURRAVE NË PUNË**

*(29 maj 1990)*

Këshilli i Komuniteteve Evropiane

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian,

Duke pasur parasysh që sjellja me një natyrë seksuale, ose çdo sjellje tjetër që bazohet tek seksi që cenon dinjitetin e grave dhe burrave në punë, përfshirë sjelljen e eprorëve dhe kolegëve, është e papranueshme dhe, në rrethana të caktuara, mund të jetë në kundërshtim me parimin e trajtimit barabartë brenda kuptimit të neneve 3, 4 dhe 5 të Direktivës së Këshillit 76/207/KES, të datës 9 shkurt 1976, në lidhje me zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për gratë dhe burrat për sa i përket të drejtës për punësim, trajnim dhe promovim profesional dhe kushte pune, një pikëpamje që mbështetet nga e drejta e praktikës gjyqësore në disa shtete anëtare;

Duke pasur parasysh që, në përputhje me Rekomandimin e Këshillit të datës 13 dhjetor 1984, në lidhje me nxitjen e një aksioni pozitiv për gratë, shumë shtete anëtare kanë ndërmarrë një numër masash aksioni pozitiv dhe veprime që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me respektimin e dinjitetit të grave në vendin e punës;

Duke pasur parasysh që Parlamenti Evropian, në rezolutën e tij të datës 11 qershor 1986 në lidhje me dhunën ndaj grave, i ka bërë thirrje autoriteteve kombëtare që të përpiqen për të arritur një përkufizim ligjor për ngacmimin seksual dhe i ka vënë thirrje qeverive kombëtare, komiteteve për mundësitë e barabarta dhe sindikatave që të ndërmarrin fushata të bashkërenduara informuese për të krijuar një sensibilizim të përshtatshëm për të drejtat individuale të të gjithë anëtarëve të forcës punëtore;

Duke pasur parasysh që Këshilli është i interesuar që të marrë parasysh studimin i cili e konsideron ngacmimin seksual si një problem serioz për shumë gra punonjëse në Komunitetin Evropian dhe është një pengesë për integrimin e duhur të grave në tregun e punës;

Duke pasur parasysh që Komiteti Këshillimor për Mundësitë e Barabarta ndërmjet Grave dhe Burrave, në opinionin e tij të datës 20 qershor 1988, ka rekomanduar unanimisht se duhet të bëhet një rekomandim dhe një kod sjelljeje në lidhje me ngacmimin seksual në vendin e punës që të mbulojë ngacmimet në të dy seksin;

1. Pohon, se sjellja e një natyre seksuale, ose çdo sjellje tjetër që bazohet tek seksi që cenon dinjitetin e grave dhe burrave në punë, përfshirë sjelljen e eprorëve dhe kolegëve, përbën një dhunim të patolerueshëm të dinjitetit të punonjësve ose rekrutëve të rinj dhe është e papranueshme nëse:

a. një sjellje e tillë është e padëshiruar, e paarsyeshme dhe fyese për personin ndaj të cilit ushtrohet;

b. kundërshtimi ose nënshtrimi i personit ndaj kësaj sjelljeje të kryer nga ana e punëdhënësve ose punonjësve (përfshirë eprorët ose kolegët) shfrytëzohet në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar si një bazë për marrjen e një vendimi i cili prek mundësinë e atij personi për t'u trajnuar profesionalisht, punësuar, vazhduar punësimin, promovuar profesionalisht, shpërblyer dhe për çdo vendim tjetër që lidhet me punësimin;

c. kjo sjellje krijon një mjedis pune frikësues, armiqësor ose poshtërues për personin ndaj të cilit ushtrohet kjo sjellje;

## 2. I bën thirrje shteteve anëtare që:

1. të zhvillojnë fushata informimi dhe sensibilizimi për punëdhënësit dhe punonjësit (përfshirë eprorët dhe kolegët), duke marrë parasysh praktikën më të mirë që ekziston në një numër shtetesh anëtare, për të luftuar sjelljen e padëshiruar të një natyre seksuale ose çdo sjellje tjetër që bazohet tek seksi që cenon dinjitetin e grave dhe burrave në punë;

2. të nxisin sensibilizimin që sjellja e përshkruar në paragrafin 1 mund të jetë, në rrethana të caktuara, në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë brenda kuptimit të neneve 3, 4 dhe 5 të Direktivës së Këshillit 76/207/KES;

3. t'i kujtojnë punëdhënësve se ata kanë përgjegjësinë që të përpiqen për të siguruar që në mjedisin e punës të mos ekzistojë asnjë:

a. sjellje e padëshiruar e një natyre seksuale ose sjellje të tjera që bazohen tek seksi që cenojnë dinjitetin e grave dhe burrave në punë;

b. viktimizim i ndonjë ankuesi ose i një personi që dëshiron të japë, ose jep, prova në rastin e një ankese;

4. të zhvillojnë masa të përshtatshme pozitive në përputhje me legjislacionin kombëtar në sektorin publik që mund të shërbejnë si një shembull për sektorin privat;

5. të marrin në konsideratë faktin se të dy palët e industrisë, në kohën që respektojnë autonominë e tyre dhe duke iu nënshtruar traditave dhe praktikave kombëtare, mund të shqyrtojnë në kontekstin e procesit të marrëveshjeve kolektive çështjen e përfshirjes së dispozitave të përshtatshme në marrëveshje, që synojnë arritjen e një mjedisi pune në mënyrën e përshkruar në paragrafin 3;

## 3. I bën thirrje Komisionit që:

1. të vazhdojë përpjekjet e tij për të informuar dhe sensibilizuar punëdhënësit, punonjësit (përfshirë eprorët dhe kolegët) avokatët dhe anëtarët e gjykatave, tribunalëve dhe autoritetet e tjera kompetente për rëndësinë e konceptit të parashikuar në paragrafin e

dhe për faktin se, në rrethana të caktuara, mosrespektimi i këtij koncepti mund të jetë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë brenda kuptimit të neneve 3, 4 dhe 5 të Direktivës 76/207/KES;

2. të hartojë deri në datën 1 korrik 1991, në konsultim me të dy palët e industrisë dhe në vijim të konsultimeve me shtetet anëtare dhe autoritetet kombëtare për mundësitë e barabarta, një kod sjelljeje në lidhje me mbrojtjen e dinjitetit të grave dhe burrave në punë i cili do të japë orientime, bazuar në shembujt dhe praktikatat më të mira në shtetet anëtare, në lidhje me ndërmarrjen dhe ndjekjen e masave pozitive që janë hartuar me qëllim krijimin e një klime në punë ku gratë dhe burrat të respektojnë integritetin njerëzor të njëri-tjetrit.

4. I bën gjithashtu thirrje institucioneve dhe organeve të Komuniteteve Evropiane që:

1. të respektojnë konceptin e parashikuar në paragrafin 1;

2. të zhvillojë masa pozitive veprimi që synojnë arritjen e një mjedisi pune në mënyrën e parashikuar në paragrafin 2.